

12116; deklarata NN, FDH-12095; deklarata K, FDH-12101; deklarata A.Ž, FDH-12089; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

---

## Julka (Blagota Nikčević)

### Đuričković

(12.02.1932, serbe nga Deçani/Deçane, e martuar, pensioniste)

Julka me bashkëshortin Veljkon banonte në ndërtesën që gjendej në Rrugën *Mbreti Dushan* në **Deçan/Deçane**. Para shkuarjes në pension, punonte në librarin *Bashkimi/Jedinstvo*. Në datën **26.05.1998**, Julka e ka përcjell motrën Branken në punë. Pastaj ka shkuar për ta kontrolluar shtëpinë familjare, e cila ndodhej jo larg apartamentit të saj, në Rrugën *Asim Vokshi*, numër 2. Pas mbërritjes atje, ajo së pari deshi të shkonte t'i ushqente shpezët, por në pragun e shtëpisë ishte shtënë mbi të nga shpina. Ka ndërruar jetë menjëherë. Trupin e pajetë të Julkes e ka gjetur bashkëshorti i saj, Veljko. Duke e parë ashtu të shtrirë në tokë dhe pa shenja jete, ai menjëherë e kreu vetëvrasjen, duke shtënë me revole në gojën e vet. Po atë ditë, policia i ka çuar trupat e tyre në *Manastirin e Deçanit/Visoki Deçani*. Një ditë më vonë, varrimin e tyre e ka kryer kleri i manastirit në varrezat e qytetit në Deçan/Deçane. Julka dhe Veljko u varrosën së bashku. Për shkak të situatës së tensionuar në qytet, askush nga farefisi nuk ka guxuar të merrte pjesë në ceremoninë mortore.

**Burimet:** deklarata B.D, FDH-27928; deklarata R.I, FDH-12117; deklarata NN, FDH-12104; deklarata NN, 12095; deklarata K, FDH-12101; SMIP, *Teroristički...*, III, 905; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; deklarata B.D, FDH-27928.

---

## Arben (Shaqë) Qerimaj

(20.05.1976, shqiptar nga Gllogjani/Glodane, komuna e Deçanit/Deçani, pjesëtar i UÇK-së)

Arbeni u inkuadrua në UÇK në fillim të vitit 1998. Ka marr pjesë në aksione të shumta kundër forcave serbe në zonën *Dukagjinit/Dukadini*. Në datën **26.05.1998**, Arbeni u plagos gjatë betejës me pjesëtarë të forcave serbe, në fshatin e tij të lindjes në **Gllogjan/Glodane**. Bashkëlufëtaret e kanë çuar

menjëherë në spitalin e Irzniqit/Rznic, por, në të njëjtën ditë, ai ndërroi jetë nga plagët e rënda. E kanë varrosur në varrezat në Gllogjan/Glodane. Pas mbarimit të luftës, mbetjet mortore të Arbenit janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Gllogjan/Glodane.

**Burimet:** deklarata Z.S, FDH-12766; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; SHFEDUÇK, *Feniksë...* 6, 45-48.

---

## Tahir (Rrustem) Kadrijaj

(15.03.1929, shqiptar nga Rastavica, komuna e Deçanit/Deçani, bujk, gjashtë fëmijë)

Si edhe të gjithë bashkëfshatarët e tij, edhe Tahiri me familje e kanë braktisur fshatin më 25.05.1998, kur forcat serbe filluan sulmin mbi Rastavicën/Rastavica. U strehuan në fshatin fqinj të Prekollukës/Prekoluka. Dy ditë më vonë [27.05.1998], nga ora 19:00, Tahiri u nis për në **Rastavicë/Rastavica** për të marr disa gjësende dhe për të lëshuar bagëtinë në kullotë. Nuk u kthye atë natë. Të nesërmen, familja kishte mësuar nga vëllai i Tahirit, Sadiku, se forcat serbe e kishin vrarë Tahirin në pragun e shtëpisë, një ditë më herët. Po atë ditë, djali i Tahirit, Ragipi, së bashku me Sadikun, e kanë varrosur viktimën në një fushë në afërsi të shtëpisë familjare. Në muajin prill të vitit 2000, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Tahirit në varrezat e Rastavicës/Rastavica.

**Burimet:** deklarata R.K, FDH-19243; KMDLNJ, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 15, 16, FDH-23816.

---

## Avni (Adem) Përgjegjaj

(6.03.1966, shqiptar nga Lumbardhi/Ljumbarda, komuna e Deçanit/Deçani, një fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Avniu ka qenë zëvendës komandanti i Shtabit të UÇK-së në Lumbardhë/Ljumbarda. Ka marr pjesë në beteja të shumta me forcat serbe në zonën operative të *Dukagjinit/Dukadini*. Avniu ka rënë gjatë betejës me forcat serbe më **27.05.1998**, në **Irzniq/Rznic**. Ai sot prehet në varrezat e fshatit Lumbardhë/Ljumbarda.